



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 057 / 637 / Dt. 28 / 02 /2025

Thirrje për shpalljen e Hulumtuesit më të mirë të vitit 2024 në UKZ

Prorektorja për Hulumtime dhe Kërkime Shkencore në bazë të Rregullores për Veprimtari Shkencore në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Ref. Nr. 02/3183, datë 16/12/2024 vendosi t'i propozojë Senatit të UKZ - së të shpall konkursin për Hulumtuesin më të mirë të vitit 2024.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet në bazë të Kriterëve të cilat i ka vendos Senatit i UKZ - së, në mbledhjen e mbajtur online me votim qarkullues të mbajtur më datën 25.02.2025, sipas nenit 9 të Rregullores për Veprimtari Shkencore, Vendimi nr. 01/612, Dt. 27/02/2025.

Hulumtuesi më i mirë i vitit 2024 duhet të ketë të publikuar së paku dy punime në Web of Science ose në Scopus brenda vitit vlerësues dhe kontribute të tjera shkencore të radhitura si në tabelë.

Kandidatët për Hulumtues më të mirë të vitit 2024, duhet të aplikojnë duke plotësuar të dhënat sipas tabelës në vijim.

Emir dhe mbiemri	Grada shkencore dhe akademike	Fusha e hulumtimeve shkencore

Nr	Lloji i kontributit shkencor	Punimi/Revista-Konferenca- Botuesi	Data, viti, linku	Pikë
1.	Punimet e publikuara ne revistat ndërkombëtare të indeksuara sipas UA të MASHT- it, nr. 01-2018,			1.0

	datë 19.01.2018, neni 3 paragrafi 1.1 dhe 1.2 saktësisht të indeksuara në Clarivate Analytics Web of Science, (koleksioni bërthamë SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS			
2.	Punimet e publikuara në revistat rajonale dhe vendore			0.5
3.	Punimet e prezantuara në konferenca ndërkombëtare me dëshmi të botimit në procedings			0.5
4.	Tekstet universitare			0.7
5.	Punimet e prezentuara në revistën e UKZ-së			0.5
6.	Punimet e prezentuara në konferenca ndërkombëtare me dëshmi të botimit në librin e abstrakteve			0.3
7.	Punime të prezentuara në konferenca ndërkombëtare si poster			0.3
8.	Punimet e prezentuara në konferenca rajonale dhe vendore me dëshmi të botimit në librin e abstrakteve			0.3
9.	Çdo citim brenda vitit vlerësues që indeksohet në WoS dhe SCOPUS			0.1

Punimet e publikuara në revista merren në konsideratë, nëse kandidati për hulumtues të vitit është autorë i parë, autorë i dytë ose korrespondent, kurse punimet në konferenca nëse kandidati është autorë i parë ose i dytë.

Në të gjitha këto punime autorët duhet të prezantohen me adresën e Universitetit Publik “Kadri Zeka” (affiliations).

Kandidatët që paraqiten në konkursin për hulumtuesin e vitit 2024 duhet t'i bashkëngjeshin aplikacionit të gjitha dokumentet, përfshirë punimet e botuara në revista shkencore, si dhe certifikatat për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare.

Aplikacionet e kandidatëve duhet të dorëzohen në Arkivin e UKZ-së dhe të skanuara në emailin: arjete.rexhepi@uni-gjilan.net, deri më datën 04.03.2025.

Me respekt,

Prof. Ass. Dr. Arbona Xhemajli

Prorektore për Hulumtime dhe Kërkime Shkencore

Arbona Xhemajli